



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-04

**Prokurori kundër Pjetër Shalës**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 10 shtator 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Version i Redaktuar Publik i**

**Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës**

---

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtësit të të akuzuarit**

Zhan-Lui Zhilisen

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në pajtim me nenin 41(6), (10) dhe (12) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullën 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), nxjerr këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 19 qershor 2020, në vijim të vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për konfirmimin e Aktakuzës ("Vendimi i Konfirmimit"),<sup>2</sup> Prokurori i Specializuar paraqiti Aktakuzën e Konfirmuar.<sup>3</sup>
2. Më 16 mars 2021, në vijim të vendimit dhe fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,<sup>4</sup> Pjetër Shala ("z. Shala" ose "i akuzuari") u arrestua në Mbretërinë e Belgjikës ("Belgjika").<sup>5</sup>
3. Më 15 prill 2021, me përfundimin e procedurave gjyqësore në Belgjikë, z. Shala u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("DHS") në Hagë, Holandë.<sup>6</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-04, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-04, F00007, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 6 maj 2021, F00007/RED.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-04, F00010, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar*, 19 qershor 2020, publik, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe shtojcën 2, konfidenciale. Versioni konfidencial me më pak redaktime dhe versioni publik i redaktuar më tej i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 31 mars 2021, F00016/A01, konfidencial, F00016/A02, publik.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-04, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimit dhe Urdhrit të Transferimit*, 12 qershor 2020, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u nxor më 6 maj 2021, F00008/RED. KSC-BC-2020-04, F00008/A01, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Fletarrestimi për z. Pjetër Shala*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik u nxor më 15 prill 2021, F00008/A01/RED.

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-04, F00013, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)*, 16 mars 2021, publik.

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-04, F00019/RED, Administratorja, *Version i Redaktuar Publik i "Njoftimit për Pranimin e Pjetër Shalës në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për Caktimin me Kusht të Mbrojtësit"*, *parashtrimi i protokolluar F00019 i datës 15 prill 2021*, 26 prill 2021, publik, me shtojcat 1-2, konfidenciale.

4. Më 15 qershor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake refuzoi kërkesën për lirim të përkohshëm të paraqitur nga Mbrojtja e z. Shala ("Mbrojtja") dhe urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të tij ("Vendimi i Parë për Paraburgimin").<sup>7</sup>
5. Më 28 qershor 2021, Mbrojtja apeloj vendimin e parë për paraburgimin ("Apeli").<sup>8</sup>
6. Më 2 gusht 2021, pasi Mbrojtja nuk dorëzoi parashtrime në lidhje me rishikimin e paraburgimit të z. Shala në përputhje me afatin e përcaktuar në Vendimin e Parë për Paraburgimin,<sup>9</sup> Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi parashtrimet e saj në lidhje me këtë çështje ("Parashtrimet e ZPS-së").<sup>10</sup>
7. Më 10 gusht 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi kërkesën e Mbrojtjes për të dorëzuar parashtrime në përgjigje të parashtrimeve të ZPS-së jo më vonë se dhjetë ditë pas njoftimit të vendimit të panelit të Gjykatës së Apelit mbi apelin dhe gjithashtu urdhëroi ZPS-në që, nëse dëshironte, të plotësonte parashtrimet e saj jo më vonë se pesë ditë pas njoftimit të vendimit të panelit të Gjykatës së Apelit.<sup>11</sup>
8. Më 20 gusht 2021, paneli i Gjykatës së Apelit e refuzoi apelin ("Vendimi i Gjykatës së Apelit").<sup>12</sup> ZPS-ja nuk i ka plotësuar parashtrimet e saj pas vendimit të Gjykatës së Apelit.

---

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-04, F00045, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Pjetër Shalës për Lirim të Përkohshëm*, 15 qershor 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u nxor më 23 qershor 2021, F00045/RED.

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-04, IA001/F00001, Mbrojtja e z. Shala, *Apel i Mbrojtjes kundër "Vendimit mbi Kërkesën e Pjetër Shalës për Lirim të Përkohshëm"*, 28 qershor 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 31 gusht 2021, IA001/F00001/RED.

<sup>9</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 50(d).

<sup>10</sup> KSC-BC-2020-04, F00058, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Parë të Paraburgimit*, 2 gusht 2021, publike; Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 50(e).

<sup>11</sup> KSC-BC-2020-04, F00060, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Ndryshim të Afatit*, 10 gusht 2021, publik, para. 11, 12, 14.

<sup>12</sup> KSC-BC-2020-04, IA001/F00005, paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit në lidhje me Lirimin e Përkohshëm*, 20 gusht 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën ditë, IA001/F00005/RED.

9. Më 1 shtator 2021, Mbrojtja dorëzoi parashtrimet e saj në lidhje me rishikimin e paraburgimit të z. Shala ("Parashtrimet e Mbrojtjes").<sup>13</sup>

10. Më 9 shtator 2021, Administratorja dorëzoi një parashtrim të protokolluar në të cilin trajtoheshin çështjet e ngritura nga Mbrojtja në parashtrimet e saj në lidhje me kushtet e paraburgimit të z. Shala ("Parashtrimet e Administratores").<sup>14</sup>

## II. PARASHTRIMET

11. ZPS-ja parashtron se vazhdimi i paraburgimit të z. Shala është i domosdoshëm dhe i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake të urdhërojë vazhdimin e paraburgimit të të akuzuarit.<sup>15</sup> ZPS-ja është e mendimit se nuk ka pasur ndonjë ndryshim të rëndësishëm të rrethanave që t'i bëjë më pak të rëndësishme arsyet e përcaktuara për paraburgim, dhe se rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit në fakt janë shtuar që nga vendimi i parë për paraburgimin.<sup>16</sup>

12. Mbrojtja i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake të urdhërojë lirimin e përkohshëm të z. Shala, në varësi të kushteve që gjykohen të përshtatshme.<sup>17</sup>

## III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

13. Neni 41(6) i Ligjit parasheh që Dhomat e Specializuara urdhërojnë paraburgimin e një personi vetëm kur ekziston dyshimi i bazuar se personi ka kryer vepër penale brenda juridiksionit të DHS-së dhe kur ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se personi: (i) përbën rrezik për arratisje; (ii) do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose

---

<sup>13</sup> KSC-BC-2020-04, F00066, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Parë të Paraburgimit*, 1 shtator 2021 (vënë në dispozicion më 2 shtator 2021), publike.

<sup>14</sup> KSC-BC-2020-04, F00073, Administratorja, *Parashtrim i Administratores sipas Rregullës 23(2) në lidhje me Kushtet e Paraburgimit*, 9 shtator 2021, konfidencial.

<sup>15</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 8.

<sup>16</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 1.

<sup>17</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 6, 44.

falsifikojë prova të veprës penale ose rrethana të caktuara tregojnë se personi do të pengojë ecurinë e procedurës penale; ose (iii) do ta përsërisë veprën penale, do të përfundojë ndonjë vepër penale në tentativë, ose do të kryejë ndonjë vepër penale që ka kërcënuar se do ta kryejë.

14. Neni 41(10) i Ligjit parasheh që, deri në kohën kur aktgjykimi merr formë të prerë ose deri në lirim nga paraburgimi, pas kalimit të dy (2) muajve nga vendimi i fundit për mbajtje në paraburgim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose trupi gjykues i ngarkuar me çështjen shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim dhe nxjerr vendimin për vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit. Kjo parashikohet edhe në rregullën 57(2) të Rregullores.

15. Neni 41(12) i Ligjit përcakton se krahas mbajtjes në paraburgim, mund të urdhërohen edhe masat në vijim për të siguruar praninë e të akuzuarit, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale apo për të siguruar kryerjen e suksesshme të procedimit penal: fletëthirrja, arrestimi, dorëzania, arresti shtëpiak, premtimi për të mos u larguar nga vendbanimi, ndalimi për t'iu afruar vendeve ose personave të caktuar, paraqitja në një stacion policie apo vend tjetër dhe masa alternative shmangëse.

16. Në përputhje me rregullën 56(2) të Rregullores, paneli siguron që personi të mos mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes dhe, në rast të ndonjë vonese të paarsyeshme të shkaktuar nga Prokurori i Specializuar, paneli, pas dëgjimit të palëve, mund ta lirojë personin me kushte që i gjykon të përshtatshme.

#### IV. DISKUTIM

##### A. STANDARDI I ZBATUESHËM

17. ZPS-ja parashtron se vendimi në bazë të rregullës 57(2) të Rregullores lidhet në mënyrë të pashmangshme me ndryshimin e rrethanave, nëse ka ndonjë ndryshim të

tyre, që nga vendimi i fundit për paraburgimin.<sup>18</sup> Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka detyrimin të bëjë konstatime në lidhje me faktorë që tashmë janë vendosur në vendimin e parë për paraburgimin.<sup>19</sup>

18. Mbrojtja përgjigjet se sipas kornizës ligjore të DHS-së, për të kryer një vlerësim të plotë nëse ende ekzistojnë arsyet për mbajtje në paraburgim, nuk kërkohet të ketë pasur ndryshim të rrethanave.<sup>20</sup> Ajo shton se ZPS-ja ka detyrimin të vërtetojë se paraburgimi i të akuzuarit është i domosdoshëm dhe se sa më gjatë të mbahet në paraburgim z. Shala, aq më i madh bëhet ky detyrim për ZPS-në.<sup>21</sup>

19. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, sipas nenit 41(10) të Ligjit, ai ka detyrimin të shqyrtojë nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim, përfshirë arsyet e përcaktuara në nenin 41(6) të Ligjit, konkretisht nëse: (i) ekziston dyshimi i bazuar se personi ka kryer veprën ose veprat penale; dhe (ii) ka arsye të artikulueshme për të besuar se ekziston ndonjë nga rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit.<sup>22</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka detyrimin të bëjë konstatime në lidhje me faktorë që tashmë janë vendosur në vendimin e parë për paraburgimin, por duhet t'i shqyrtojë këto arsye ose rrethana dhe të përcaktojë nëse ato ende ekzistojnë. Thelbësore është që në kohën e rishikimit të vendimit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake të bindet se ende ekzistojnë arsyet për vazhdimin e paraburgimit.<sup>23</sup> ZPS-ja ka detyrimin të vërtetojë se paraburgimi i të akuzuarit është i domosdoshëm.<sup>24</sup>

---

<sup>18</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 3.

<sup>19</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 3.

<sup>20</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 7.

<sup>21</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 4, 7.

<sup>22</sup> *Shih për shembull* KSC-BC-2020-07, F00143, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hysni Gucatit*, 24 shkurt 2021, publik, para. 17.

<sup>23</sup> KSC-BC-2020-07, IA002/F00005, paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Nasim Haradinajt kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit*, 9 shkurt 2021, para. 55.

<sup>24</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 13, me referenca shtesë.

## B. DYSHIMI I BAZUAR

20. Sa i përket standardit lidhur me vazhdimin e paraburgimit, neni 41(6)(a) i Ligjit së pari kërkon ekzistencën e dyshimit të bazuar se personi i paraburgosur ka kryer vepër penale që përfshihet në juridiksionin e DHS-së. Ky është një kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimin të paraburgimit të të paraburgosurit.<sup>25</sup>

21. Sipas ZPS-së, për arsyet e shtjelluara në Vendimin e Konfirmimit, vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se i akuzuari ka kryer një numër veprash penale që përfshihen në juridiksionin e DHS-së.<sup>26</sup> Mbrojtja nuk ka dorëzuar ndonjë parashtrim në lidhje me këtë faktor.

22. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se në Vendimin e Konfirmimit, konstatohej se, në përputhje me nenin 39(2) të Ligjit, ekziston dyshimi i bazuar se z. Shala mban përgjegjësi penale për një numër krimesh lufte (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme) sipas neneve 14(1)(c) dhe 16(1)(a) të Ligjit.<sup>27</sup> Standardi mbi të cilin u bazuan këto konstatime ishte më i lartë se sa ai i dyshimit të bazuar që kërkohet sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit.<sup>28</sup>

23. Në mungesë të ndonjë informacioni apo zhvillimi të ri në lidhje me këtë vendim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kriteri i përcaktuar në nenin 41(6)(a) të Ligjit vijon të përmbushet.

## C. DOMOSDOSHMËRIA E PARABURGIMIT

24. Pas përmbushjes së standardit të nenit 41(6)(a) të Ligjit, arsyet që përlegjin heqjen e lirisë së personit duhet të jenë të artikulueshme, në kuptimin që duhet të

---

<sup>25</sup> Ngjashëm, ECtHR, *Merabishvili v. Georgia* [GC], no. 72508/13, [Judgment](#), 28 November 2017, para. 222, me referenca shtesë.

<sup>26</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 2, 5.

<sup>27</sup> Vendimi i Konfirmimit, para. 140(a). *Shih gjithashtu* Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 15.

<sup>28</sup> Vendimi i Konfirmimit, para. 35.



specifikohen me hollësi.<sup>29</sup> Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, bazuar në provat e disponueshme, arsyet konkrete të artikulueshme duhet të mbështesin “besimin”<sup>30</sup> se ekziston ndonjë prej rreziqeve të parapara në secilin prej tre nënparagrafëve të nenit 41(6)(b) të Ligjit, çka nënkupton pranimin e mundësisë, e jo të pashmangshmërisë, se ato mund të ndodhin në të ardhmen.<sup>31</sup> Me fjalë të tjera, standardi që duhet të zbatohet është më i ulët se pashmangshmëria, por më i lartë se thjesht mundësia që rreziku të materializohet.<sup>32</sup> Gjatë marrjes së vendimit nëse një person duhet të lirohet apo të mbahet në paraburgim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të shqyrtojë masat alternative për parandalimin e rreziqeve të parapara në nenin 41(6)(b) të Ligjit.<sup>33</sup>

## 1. Rreziku i arratisjes

25. Sipas ZPS-zë, rreziku i arratisjes së z. Shala vazhdon të ekzistojë.<sup>34</sup> Ajo shton se ky rrezik mund të jetë shtuar pasi, më 31 korrik 2021, ai mori një pjesë të konsiderueshme të materialit të mbetur që u nxor sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores.<sup>35</sup>

26. Mbrojtja përgjigjet se e drejta për t’u njohur me provat është një nga të drejtat themelore procedurale të çdo të akuzuari dhe se përdorimi i kësaj të drejte në dëm të z. Shala, si një faktor që përlligj mbajtjen e tij të mëtejshme në paraburgim, është thellësisht e padrejtë.<sup>36</sup> Gjithashtu, Mbrojtja fton Gjykatësin e Procedurës Paraprake të

<sup>29</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 16, me referenca shtesë.

<sup>30</sup> *Shih pjesën e përgjithshme të nenit 41(6)(b) të Ligjit.*

<sup>31</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 16, me referenca shtesë.

<sup>32</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 16, me referenca shtesë.

<sup>33</sup> KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave Miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, 26 prill 2017, publik, para. 114. Shih gjithashtu ECtHR, Buzadji v. the Republic of Moldova [GC], no. 23755/07, [Judgment](#), 5 July 2016 (“Buzadji v. the Republic of Moldova [GC]”), para. 87 *in fine*; ECtHR, *Idalov v. Russia* [GC], no. 5826/03, [Judgment](#), 22 May 2012, para. 140 *in fine*.*

<sup>34</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 5, 6.

<sup>35</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 4.

<sup>36</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 18-19.



rivlerësojë konstatimet e tij në lidhje me ekzistencën e rrezikut të moderuar të arratisjes dhe të konstatojë se aktualisht një rrezik i tillë nuk ekziston, duke marrë parasysh, krahas historisë së mëhershme të bashkëpunimit të shkëlqyer të tij me autoritetet gjyqësore dhe hetimore, edhe lidhjen e fortë të z. Shala me Belgjikën, faktin që ai është vetëdistancuar plotësisht nga elitat politike në Kosovë dhe nuk ka ndonjë rrjet përkrahësish.<sup>37</sup> Mbrojtja gjithashtu fton Gjykatësin e Procedurës Paraprake të rivlerësojë konstatimet e tij në lidhje me aftësinë e z. Shala për t'u mbështetur në një rrjet përkrahësish, kontekstin e atmosferës së përgjithshme të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë në gjykimet e ish-anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK"), si dhe kundërshtimin e z. Shala ndaj DHS-së, duke pasur parasysh konstatimet e Gjykatës së Apelit që kërkojnë bërjen e konstatimeve konkrete mbi ekzistencën e një rrjeti të pretenduar përkrahësish, prova të mjaftueshme që çojnë në përfundimin e arsyeshëm se i akuzuari mund të mobilizojë realisht një rrjet përkrahësish dhe arsye konkrete që përlligjin rëndësinë e mosnjohjes së legjitimitetit të DHS-së nga i akuzuari.<sup>38</sup>

27. Duke qenë se Mbrojtja fton Gjykatësin e Procedurës Paraprake të rivlerësojë konstatimet e bëra në Vendimin e Parë për Paraburgimin në lidhje me rrezikun e arratisjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se në vendimin e fundit, faktet se z. Shala ka lidhje me Belgjikën, se është larguar dhe vetëdistancuar nga Kosova dhe se u është përgjigjur fletëthirrjeve në kontekstin e proceseve të ndryshme gjyqësore, janë shqyrtuar shprehimisht.<sup>39</sup> Megjithatë, u arrit në përfundimin se këto fakte ose nuk i zhvlerësojnë faktorët e tjerë që mbështesin rrezikun e arratisjes, ose e zvogëlojnë këtë rrezik në mënyrë të pamjaftueshme.<sup>40</sup> Në mënyrë të ngjashme, sa i përket ftesës së Mbrojtjes për të rivlerësuar disa konstatime që përmban Vendimi i Parë për Paraburgimin mbi bazën e disa konstatimeve të bëra nga Gjykata e Apelit, u shpjegua

---

<sup>37</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 20.

<sup>38</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 21-22.

<sup>39</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 25-27.

<sup>40</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 25-27.

konkretisht se, bashkë me faktin që z. Shala u vu në dijeni për dyshimin e bazuar mirë se ai ishte anëtar i ndërmarrjes kriminale të përbashkët ("NKP"), veçoritë e NKP-së së pretenduar në këtë çështje gjyqësore dhe refuzimi i dokumentuar i legjitimitetit të DHS-së nga z. Shala, e shtojnë rrezikun e arratisjes së tij.<sup>41</sup>

28. Pas shqyrtimit të faktorëve dhe rrethanave të përshkruara në Vendimin e Parë për Paraburgimin, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vijon të jetë i bindur se ato vazhdojnë të ekzistojnë. Z. Shala: (i) është në dijeni të akuzave të rënda kundër tij, të mundësisë së marrjes së një dënimi të rëndë për ato akuza në rast se shpallet fajtor dhe të vendimit të formës së prerë për fajësinë e dy anëtarëve të NKP-së, anëtar i së cilës pretendohet se ka qenë edhe ai; dhe (ii) refuzon legjitimitetin e DHS-së.<sup>42</sup> Gjithashtu: (i) përmasat relativisht të vogla të grupit që përbën NKP-në e pretenduar dhe fakti që ngjarjet mbi të cilat bazohen akuzat janë lehtësisht të dallueshme, e rrisin mundësinë që anëtarët e pretenduar të tij të ndihmojnë reciprokisht njëri-tjetrin, përfshirë edhe ndihmën që mund t'i japin njëri-tjetrit për t'u arratisur; dhe (ii) ekziston një kontekst i përgjithshëm i një atmosfere të përgjithshme, të rrënjosur dhe të vazhdueshme të ndërhyrjes në proceset penale që kanë lidhje me UÇK-në dhe të frikësimit të dëshmitarëve.<sup>43</sup> Këta faktorë dhe rrethana vijnë të vërtetojnë se aktualisht ekziston një rrezik i moderuar që z. Shala të arratiset. Sidoqoftë, duke pasur parasysh se këta faktorë dhe rrethana nuk varen nga nxjerrja e materialit në të cilin mbështeten akuzat kundër z. Shala dhe në mungesë të një arsyetimi konkret nga ZPS-ja, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se nxjerrja e materialit shtesë nuk e ka shtuar rrezikun e arratisjes.

---

<sup>41</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 25-26.

<sup>42</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 24-25.

<sup>43</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 26.

## 2. Rreziku i pengimit të ecurisë së procedurave të DHS-së

29. Sipas ZPS-së, vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Shala të pengojë ecurinë e procedurave të DHS-së.<sup>44</sup> ZPS-ja parashtron se ky rrezik mund të jetë shtuar pasi, më 31 korrik 2021, ai mori një pjesë të konsiderueshme të materialit të mbetur që u nxor sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores.<sup>45</sup>

30. Mbrojtja përgjigjet se e drejta për t'u njohur me provat është një nga të drejtat themelore procedurale të çdo të akuzuari dhe se përdorimi i kësaj të drejte në dëm të z. Shala, si një faktor që përlligj mbajtjen e tij të mëtejshme në paraburgim, është thellësisht e padrejtë.<sup>46</sup> Ajo shton se ZPS-ja nuk ka paraqitur prova konkrete që vërtetojnë në mënyrë të mjaftueshme mundësinë reale që z. Shala do të pengojë procedurat e DHS-së.<sup>47</sup> Gjithashtu, Mbrojtja shton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të marrë parasysh masat e shumta mbrojtëse të vendosura në këtë çështje gjyqësore dhe faktin se nuk ka prova që sugjerojnë se z. Shala (ose kushdo që ka lidhje me të) ka aftësinë ose mundësinë të anashkalojë këto masa dhe të identifikojë dëshmitarët e mbrojtur të pidentifikuar ose të ketë qasje apo të kontaktojë dëshmitarët e mbrojtur të identifikuar, veçanërisht duke pasur parasysh kushtet e propozuara për lirim të tij.<sup>48</sup>

31. Sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, argumenti i përgjithshëm i Mbrojtjes se ZPS-ja nuk ka ofruar prova konkrete që vërtetojnë në mënyrë të mjaftueshme mundësinë reale që z. Shala do të pengojë procedurat e DHS-së, është i pabazë dhe, si pasojë, nuk do të trajtohet më tej. Sa i përket parashtrimeve të Mbrojtjes në lidhje me ekzistencën e masave mbrojtëse, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se, në rrethanat konkrete të çështjes gjyqësore aktuale, ekzistenca e masave mbrojtëse demonstroi një rrezik të shtuar të pengimit të procesit. Si rezultat i fushëveprimit

---

<sup>44</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 2, 5, 6.

<sup>45</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 4.

<sup>46</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 18-19.

<sup>47</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 24.

<sup>48</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 25-31.

relativisht të kufizuar të akuzave kundër z. Shala, që lidhen vetëm me një vend dhe kanë të bëjnë me akte që kanë ndodhur gjatë disa javëve, ngjarjet mbi të cilat bazohen akuzat janë lehtësisht të dallueshme. Kjo i bën viktimat dhe dëshmitarët në çështjen gjyqësore aktuale më të identifikueshëm se sa në proceset e tjera, që përfshijnë akuza më të gjera. Sidoqoftë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se z. Shala [REDAKTUAR] dhe madje ka [REDAKTUAR].<sup>49</sup> Si rezultat, ekzistenca e masave mbrojtëse nuk mund të ndikojë në konstatimin se, [REDAKTUAR], z. Shala do të pengojë ecurinë e procedurave të DHS-së.<sup>50</sup>

32. Rikujtojmë këtu se [REDAKTUAR]. Gjithashtu, duke pasur parasysh konstatimet në lidhje me masat mbrojtëse, Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se nxjerrja e mëtejshme e materialit për z. Shala shton rrezikun e pengimit të procesit. Rrjedhimisht rreziku që z. Shala të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së vazhdon të ekzistojë.

### **3. Rreziku i kryerjes së krimeve të tjera**

33. Sipas ZPS-së, rreziku që z. Shala të kryejë krime të tjera vazhdon të ekzistojë.<sup>51</sup> ZPS-ja shton se ky rrezik mund të jetë shtuar pasi, më 31 korrik 2021, ai mori një pjesë të konsiderueshme të materialit të mbetur që u nxor sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores.<sup>52</sup>

34. Mbrojtja përgjigjet se e drejta për t'u njohur me provat është një nga të drejtat themelore procedurale të çdo të akuzuari dhe se përdorimi i kësaj të drejte në dëm të z. Shala, si një faktor që përlligj mbajtjen e mëtejshme të tij në paraburgim, është thellësisht e padrejtë.<sup>53</sup> Gjithashtu, Mbrojtja përsërit parashtrimet e saj se nuk ka prova

---

<sup>49</sup> Vendimi i Gjykatës së Apelit, para. 37, 38.

<sup>50</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 32-35; Vendimi i Gjykatës së Apelit, para. 41.

<sup>51</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 2, 5, 6.

<sup>52</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 4.

<sup>53</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 18-19.

konkrete që demonstrojnë në mënyrë të mjaftueshme rrezikun real që z. Shala do të kryejë krime të tjera, veçanërisht duke pasur parasysh masat e shumta që po zbatohen për mbrojtjen e dëshmitarëve.<sup>54</sup>

35. Siç u konstatua më lart në lidhje me rrezikun e pengimit të procesit, parashtrimi i përgjithshëm i Mbrojtjes se nuk ka prova konkrete që demonstrojnë në mënyrë të mjaftueshme rrezikun real se z. Shala do të kryejë krime të tjera, është i pabazë dhe nuk do të shqyrtohet më tej. Gjithashtu, për arsyet e parashtruara në lidhje me rrezikun që z. Shala të pengojë ecurinë e procedurave të DHS-së, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se, në rrethanat e çështjes gjyqësore aktuale, nevoja për masa mbrojtëse demonstroi një rrezik të shtuar të kryerjes së krimeve të tjera.

36. Në Vendimin e Parë për Paraburgimin u konstatua se ekziston rreziku që z. Shala të kryejë krime të tjera, pasi [REDAKTUAR].<sup>55</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbetet i vetëdijshëm për faktin se ekzistenca e rrezikut të pengimit të procesit nuk nënkupton automatikisht rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera, por përsërit se, në çështjen gjyqësore aktuale, faktorët mbi të cilët mbështetet rreziku i parë janë me rëndësi edhe për vlerësimin e këtij të fundit.<sup>56</sup> Sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, rreziku që z. Shala të kryejë krime të tjera vazhdon të ekzistojë, duke pasur parasysh se z. Shala [REDAKTUAR]. Gjithashtu, ashtu si me rrezikun e pengimit të procesit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se, duke pasur parasysh konstatimin e mëparshëm në lidhje me ekzistencën e masave mbrojtëse, nxjerrja e materialit shtesë shton rrezikun që z. Shala të kryejë krime të tjera.

---

<sup>54</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 32.

<sup>55</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 39.

<sup>56</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 39.

#### 4. Përfundim

37. Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Shala të arratiset, të pengojë ecurinë e procedurave të DHS-së ose të kryejë krime të tjera kundër atyre që konsiderohen se janë kundër UÇK-së, përfshirë dëshmitarët që kanë dhënë dëshmi për ZPS-së dhe/ose pritët të paraqiten para DHS-së. Gjykatësi i Procedurës Paraprake në vijim do të vlerësojë nëse kushtet e propozuara nga Mbrojtja mund t'u përgjigjen në mënyrën e duhur këtyre rreziqeve.

#### D. LIRIMI ME KUSHT

38. ZPS-ja parashtron se asnjë kusht nuk i zvogëlon në mënyrë të mjaftueshme tre rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit.<sup>57</sup> ZPS-ja shton se këto rreziqe mund të trajtohen në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit të DHS-së dhe se çfarëdo garancish që mund të japë i akuzuari do të ishin të pamjaftueshme për të garantuar përmbushjen e kushteve apo për të përballuar rreziqet konkrete që vijnë nga nxjerrja në gjendje të lirë.<sup>58</sup>

39. Mbrojtja parashtron se nuk ka asnjë arsye të mos nxirret përfundimi se rreziku i moderuar i arratisjes mund të zvogëlohet me anë të zbatimit të kushteve të duhura.<sup>59</sup> Mbrojtja gjithashtu parashtron se çdo rrezik i paraparë në nenin 41(6)(b)(ii)-(iii) të Ligjit zvogëlohet në mënyrë të mjaftueshme me anë të kushteve të lirimimit ose arrestit shtëpiak, siç përshkruhet me hollësi në parashtrimet e Mbrojtjes.<sup>60</sup> Gjithashtu, Mbrojtja kërkon që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të urdhërojë paraqitjen e dëshmive të ekspertëve mbi monitorimin e komunikimeve në përgjithësi, dhe atë të disponueshëm në Belgjikë, duke përfshirë, nëse gjykohet e nevojshme, parashtrimet mbi kapacitetet

<sup>57</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 5.

<sup>58</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 7.

<sup>59</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 23.

<sup>60</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 37-40.

për të monitoruar komunikimet në gjuhën shqipe.<sup>61</sup> Së fundi, Mbrojtja përsërit se z. Shala është i gatshëm të marrë zotime të shumta dhe t'u nënshtrohet këtyre kushteve, përfshirë edhe arrestit shtëpiak, si ta gjykojë të përshtatshme Gjykatësi i Procedurës Paraprake.<sup>62</sup>

40. Sa i përket rrezikut të arratisjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake më herët ka konstatuar se kushtet e propozuara në Vendimin e Parë për Paraburgimin, përkatësisht zotimet e z. Shala për t'iu nënshtrohet kontrolleve të përditshme të zyrtarëve të autorizuar belgë, për të dorëzuar çdo dokument udhëtimi dhe për t'iu nënshtrohet një monitorimi të rreptë nga autoritetet belge, e zvogëlojnë në mënyrë të mjaftueshme këtë rrezik.<sup>63</sup> Duke marrë parasysh faktin që parashtrimet e përgjithshme të ZPS-së në lidhje me këtë çështje nuk janë të mbështetura me prova, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, në mungesë të ndonjë informacioni apo zhvillimi të ri në lidhje me këtë vendim, kushtet e lartpërmendura mbeten të përshtatshme për të zvogëluar rrezikun e arratisjes së z. Shala.

41. Sidoqoftë, në këndvështrimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, kushtet e propozuara të lirimit janë të papërshtatshme për të parandaluar bisedat e pamonitoruara ndërmjet z. Shala dhe individëve të tjerë, që synojnë pengimin potencial të procedurave të DHS-së ose kryerjen e krimeve të tjera.<sup>64</sup> Arsyeja është se këto kushte, ndonëse i referohen përdorimit të kufizuar të vetëm një telefoni celular që nuk është i lidhur me internetin, vetëm për komunikime të kufizuara të cilat mund të monitorohen nga DHS-ja apo nga autoritetet belge sipas rastit,<sup>65</sup> nuk trajtojnë mundësinë që z. Shala të përdorë pajisje komunikimi që u përkasin të tjerëve ose t'u kërkojë personave të tjerë të përdorin mjetet e tyre të komunikimit për këtë qëllim.<sup>66</sup>

---

<sup>61</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 41-42.

<sup>62</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 43.

<sup>63</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 45.

<sup>64</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 40(i)-(ix).

<sup>65</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 40(vi).

<sup>66</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 46.



Gjithashtu, këto kushte thjesht parashikojnë paraqitjen e përditshme para zyrtarëve të autorizuar belgë dhe kontrolle të rastësishme nga policia belge,<sup>67</sup> çka është e pamjaftueshme për të garantuar monitorimin efektiv të komunikimeve të z. Shala, duke pasur parasysh rreziqet e përmendura më sipër.

42. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se mundësia e mbajtjes në arrest shtëpiak dhe kushtet shoqëruese nuk do të parandalonin bisedat e pamonitoruara midis z. Shala dhe vizitorëve të miratuar.<sup>68</sup> Kjo do të thotë që, edhe nëse zbatohen propozimet që vizitorët e miratuar të dorëzojnë pajisjet dhe mesazhet e tyre, t'u bëhet kontroll për pajisje ose mesazhe, dhe të pajtohen me monitorimin e mëposhëm të pajisjeve të tyre,<sup>69</sup> mesazhet mund të përcillen në një numër mënyrash të tjera. Për shembull, ekziston mundësia reale që z. Shala mund t'i kërkojë një vizitori që ose ta përcjellë porosinë me gojë ose të përdorë pajisje që i përkasin një personi të tretë për ta bërë këtë. Kurse në objektin e paraburgimit të DHS-së, me autorizim gjyqësor sipas rastit, mund të merren masa për të parandaluar komunikime të tilla të paligjshme.<sup>70</sup> Vizita të tilla zhvillohen në një objekt të sigurtë dhe kryhen në përputhje me rregulla specifike dhe të detajuara që përcaktojnë, ndër të tjera, regjistrimin e vizitorëve, procedurën e paraqitjes së kërkesës për leje për vizitë dhe kushtet e sigurisë së vizitave.<sup>71</sup> Gjithashtu, përveç çështjes nëse është i mundshëm zbatimi në praktikë i kushteve të tjera, si monitorimi i vizitave nga autoritetet belge, këto kushte<sup>72</sup> nuk e zvogëlojnë mjaftueshëm rrezikun për shkak të mundësisë së përdorimit të gjuhës së koduar ose të pakuptueshme, të cilën personat që nuk kanë njohuri për procedurat e DHS-së nuk mund ta njohin ose ta parandalojnë lehtë.

---

<sup>67</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 40(iv), (ix).

<sup>68</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 40(x)-(xxii).

<sup>69</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 40(xviii)-(xx).

<sup>70</sup> Nenet 4, 7, 15 të Udhëzuesit të Punës së Zyrës Administrative në lidhje me të Paraburgosurit, Vizitat dhe Komunikimet ("Udhëzuesi i Punës për Vizitat dhe Komunikimet"), KSC-BD-09/Rev1/2020, 23 shtator 2020.

<sup>71</sup> Nenet 10-14 të Udhëzuesit të Punës për Vizitat dhe Komunikimet.

<sup>72</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 40(xxii), 43.

43. Sa i përket kërkesës së Mbrojtjes për të urdhëruar paraqitjen e dëshmime të ekspertëve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se duke pasur parasysh përmendjen e disponueshmërisë së një sërë programesh dhe pajisjesh efektive të monitorimit dhe në mungesë të hollësive të mëtejshme,<sup>73</sup> Mbrojtja po kërkon paraqitjen e dëshmime nga ekspertët lidhur me aspektet teknike të monitorimit të komunikimeve të z. Shala me anë të pajisjeve të ndryshme. Sidoqoftë, konstatimet e mëhershme se kushtet e propozuara të lirimit ose arrestit shtëpiak nuk zvogëlojnë në mënyrë të mjaftueshme rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(ii)-(iii) të Ligjit nuk bazohen vetëm në komunikimet e z. Shala me anë të pajisjeve të ndryshme. Këto konstatime dalin gjithashtu nga fakti se kushtet e propozuara të lirimit ose arrestit shtëpiak nuk parandalojnë bisedat e pamonitoruara midis z. Shala dhe vizitorëve të miratuar dhe se gjatë bisedave të tilla mund të përcillen mesazhe me gojë, ndër të tjera edhe me synimin e pengimit të procedurave të DHS-së apo të kryerjes së krimeve të tjera. Për këtë arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se në kuadër të këtij vendimi nuk është e nevojshme të urdhërohet paraqitja e dëshmime të ekspertëve dhe refuzon kërkesën e Mbrojtjes.

44. Pasi ka shqyrtuar kushtet e lirimit ose arrestit shtëpiak të propozuar nga Mbrojtja dhe mundësinë e masave shtesë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vazhdon të jetë i bindur se komunikimet e z. Shala mund të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm rreziqet e përmendura më sipër vetëm nëpërmjet zbatimit të kornizës për monitorimin e komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të DHS-së. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kushtet e propozuara të lirimit, arrestit shtëpiak ose çdo kufizim shtesë i vendosur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, janë të pamjaftueshme për të zvogëluar rrezikun që z. Shala të pengojë procesin e DHS-së ose të kryejë krime të tjera.

---

<sup>73</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 40.

## E. PROPORCIONALITETI I PARABURGIMIT

45. ZPS-ja nuk ka paraqitur ndonjë parashtrim në lidhje me proporcionalitetin e paraburgimit të z. Shala. Mbrojtja pretendon se, pasi kanë kaluar më shumë se pesë muaj nga arrestimi i z. Shala dhe duke qenë se nuk dihet data e fillimit të gjykimit, z. Shala rrezikon të qëndrojë në paraburgim më shumë kohë nga ç' duhet para fillimit të gjykimit.<sup>74</sup> Gjithashtu, sipas mendimit të Mbrojtjes, ndikimi që mbajtja në paraburgim ka pasur mbi z. Shala është joproportional, pasi ai po përballet me vështirësi të mëdha në marrjen e ushqimit dhe qasjen në kujdesin e duhur mjekësor, dhe pamundësia e vizitave të rregullta familjare përbën një ndërhyrje të tepruar në të drejtën e z. Shala për jetë private dhe familjare.<sup>75</sup>

46. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson rëndësinë e parimit të proporcionalitetit në përcaktimin e arsyeshmërisë së paraburgimit.<sup>76</sup> Kohëzgjatja e paraburgimit në pritje të gjykimit është një faktor që duhet të merret parasysh së bashku me shkallën e rreziqeve të përshkruara në nenin 41(6)(b) të Ligjit, në mënyrë që, duke mbajtur parasysh të gjithë faktorët, të përcaktohet nëse vazhdimi i paraburgimit “ka pushuar së qeni i arsyeshëm” dhe personi duhet të lirohet.<sup>77</sup> Sidoqoftë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se çështja nëse një periudhë kohe e kaluar në paraburgim është e arsyeshme nuk mund të vlerësohet teorikisht. Vlerësimi nëse vazhdimi i mbajtjes të një akuzuari në paraburgim është i arsyeshëm duhet të bëhet mbi bazën e fakteve të secilës çështje gjyqësore dhe sipas veçorive të saj specifike.<sup>78</sup>

---

<sup>74</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 3, 34.

<sup>75</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 5, 35.

<sup>76</sup> KSC-BC-2020-07, IA001/F00005, paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të lidhura me Arrestimin dhe Mbjtjen e tij në Paraburgim*, 9 dhjetor 2020, publik, para. 72-73.

<sup>77</sup> *Ngjashëm* KSC-BC-2020-06, IA004/F00005, paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Lirim të Përkohshëm*, 30 prill 2021, konfidencial, para. 69. Versioni i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën ditë, IA004/F00005/RED.

<sup>78</sup> *Buzadji v. the Republic of Moldova [GC]*, para. 90.

47. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se: (i) Z. Shala është mbajtur në paraburgim në Belgjikë që nga data 16 mars 2021 dhe më pas në objektin e paraburgimit të DHS-së që nga data 15 prill 2021; (ii) ndaj tij janë ngritur katër akuza për krime lufte që pretendohet se kanë ndodhur në Shqipëri gjatë disa javëve; (iii) nëse shpallet fajtor, ai mund të dënohet me burgim për kohë të gjatë; (iv) rreziqet e paraprara në nenin 41(6)(b)(ii) dhe (iii) të Ligjit nuk mund të zvogëlohen me kushtet e propozuara për lirim, arrest shtëpiak e as me kushte të tjera shtesë; (v) të gjitha veprimet e nevojshme procedurale në lidhje me fazën paraprake të kësaj çështjeje gjyqësore kanë përfunduar, po përfundojnë, ose do të përfundojnë, me synim kalimin e çështjes për gjykim në një të ardhme të afërt; dhe (vi) afatet kohore përkatëse ose janë respektuar, ose janë zgjatur për arsye të vlefshme – në disa raste edhe me kërkesë të z. Shala – dhe çdo kërkesë shtesë për zgjatjen e afateve do të vlerësohet sipas kriterëve ligjore përkatëse.<sup>79</sup> Mbi këtë bazë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se z. Shala nuk ka kaluar në paraburgim më tepër kohë nga ç’duhet para fillimit të gjykimit dhe se, në fazën aktuale, çdo diskutim në lidhje me kohëzgjatjen e gjithsejtë të paraburgimit paraprak të tij është i parakohshëm dhe hamendësues.

48. Sa i përket pretendimeve të Mbrojtjes në lidhje me vështirësitë që po përjeton z. Shala në marrjen e ushqimit dhe qasjen në kujdesin e duhur mjekësor, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Mbrojtja ka sqaruar se nuk do t’i shtjellojë këto çështje, pasi zyrtarët kompetentë të Zyrës Administrative janë në proces të shqyrtimit të ankesave të z. Shala.<sup>80</sup> Rrjedhimisht, në mungesë të parashtrimeve konkrete nga Mbrojtja dhe duke pasur parasysh se shqetësimet e z. Shala po shqyrtohen, edhe pse

<sup>79</sup> *Shih për shembull* KSC-BC-2020-04, F00051, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë për Ndryshim të Afatit për Mocionet Paraprake*, 2 korrik 2021, publike; F00059, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes për Zgjatje të Afatit të Përgjigjes së saj ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Parë të Paraburgimit*, 9 gusht 2021, publike; F00057, Prokurori i Specializuar, *Njoftim për Gjykatësin e Procedurës Paraprake në lidhje me Nxjerrjen e Materialeve sipas Rregullës 102(1)(b) dhe Kërkesë për Shtyrje të Kufizuar të Afatit lidhur me Detyrimin për Nxjerrjen e Provave të Caktuara*, 31 korrik 2021 (njoftuar më 2 gusht 2021), rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 4 gusht 2021, F00057/CONF/RED); F00074, Mbrojtësi i Specializuar, *Mocion i Mbrojtjes për Zgjatje të Afatit për Kërkesën e saj sipas Rregullës 102(2)*, 9 shtator 2021 (njoftuar më 10 shtator 2021).

<sup>80</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 35.

ai nuk ka dorëzuar një ankesë zyrtare,<sup>81</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se nuk është e nevojshme që këto çështje të trajtohen në kontekstin e këtij vendimi. Gjithashtu, pamundësia e vizitave të rregullta familjare përbënte një masë proporcionale dhe të përkohshme që ishte e nevojshme për shkak të shqetësimeve të lidhura me shëndetin publik, konkretisht me pandeminë aktuale të Kovid-19, dhe z. Shala është lejuar të komunikojë me familjen e tij në mënyra të tjera.<sup>82</sup> Këto kufizime tani janë hequr dhe janë caktuar vizita familjare shtesë.<sup>83</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren gjithashtu se pretendimi i Mbrojtjes se familja e z. Shala po përballet me vështirësi të mëdha për ta vizituar atë për arsye që nuk varen prej tyre, është i pabazë.<sup>84</sup> Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake hedh poshtë pretendimin e Mbrojtjes se ky kufizim përbën një ndërhyrje të tepruar në të drejtën e z. Shala për jetë private dhe familjare, që e bën joproporcional paraburgimin e tij.

## V. VENDIM

49. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- (a) **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të z. Shala;
- (b) **URDHËRON** z. Shala që, nëse dëshiron, të paraqesë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit jo më vonë se **të mërkurën, më**

---

<sup>81</sup> Parashtrimet e Zyrës Administrative, para. 8-10, 13.

<sup>82</sup> KSC-BC-2020-04, F00022, Administratorja, *Parashtrim i Administratores në Përputhje me Rregullën 23(2) mbi Masat për Zbutjen e Rrezikut nga KOVID-19*, 19 prill 2021, konfidencial, para. 37; KSC-BC-2020-04, F00048, Administratorja, *Përditësim i Parashtrimit të Administratores në Përputhje me Rregullën 23(2) mbi Masat për Zbutjen e Rrezikut nga KOVID-19*, 16 qershor 2021, konfidencial, para. 16-17; KSC-BC-2020-04, Transkripti, 21 qershor 2021, publik, f. 64, rreshtat 6-7.

<sup>83</sup> Parashtrimet e Zyrës Administrative, para. 11-12.

<sup>84</sup> Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 35.

**13 tetor 2021**, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores; dhe

(c) **URDHËRON** ZPS-në që, nëse z. Shala vendos të mos paraqesë parashtrime deri në afatin e lartpërmendur, të paraqesë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Shala jo më vonë se **të hënën, më 25 tetor 2021**, dhe z. Shala, nëse dëshiron, të paraqesë parashtrimet e tij jo më vonë se **të hënën, më 1 nëntor 2021**.

/nënshkrimi/

**Gjykatësi Nikola Giju**  
**Gjykatës i Procedurës Paraprake**

E premte, 10 shtator 2021

Në Hagë, Holandë.